



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**  
**K.P.P. 52/2020**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.02.2020, shqyrtoi kërkesën me:

**Objekt:** Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës nr. 61 prot., datë 16.01.2020 për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur – Marrëveshje kuadër*”, me objekt “*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për SUOGJ “Koco Gliozheni”*”, me nr. REF-42964-11-11-2019, me fond limit 67,179,240 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 16.12.2019, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Olta Sharra” p.f.  
*Adresa: L. “Haxhias”, Rr. “Ismail Zyma”, z.k.8525, nr.pasurie A, Elbasan*

**Autoriteti Kontraktor:** Agjencia e Blerjeve të Përqendruara  
*Adresa: Sheshi “Skënderbej”, Nr. 3, Tiranë.*

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### ***Vlerësimi paraprak***

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe të dokumentacionit të dërguar nga operatori ekonomik ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### II

#### ***Rrethanat e çështjes***

II.1. Në datën 12.11.2019 në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur – Marrëveshje kuadër*”, me objekt “*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për SUOGJ “Koco Glliozheni”*”, me nr. REF-42964-11-11-2019, me fond limit 67,179,240 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 16.12.2019, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 24.12.2019 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomik pjesëmarrës mbi vlerësimin e ofertave nëpërmjet SPE.

II.3. Në datën 06.01.2020, operatori ekonomik ankimues “Olta Sharra” p.f. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Dajti Park 2007” sh.p.k, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.4. Në datën 08.01.2020 autoriteti kontraktor ka kthyer përgjigje në lidhje me ankesën e paraqitur pranë këtij të fundit, duke mos e pranuar atë.

II.5. Në datën 16.01.2020 operatori ekonomik ankimues, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.6. Në datën 04.02.2020, operatori ekonomik ankimues “Olta Sharra” p.f. ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur – Marrëveshje kuadër*”, me objekt “*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për SUOGJ “Koco Gliozheni”*”, me nr. REF-42964-11-11-2019, me fond limit 67,179,240 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 16.12.2019, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

#### Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues “Olta Sharra” p.f. për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur – Marrëveshje kuadër*”, me objekt “*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për SUOGJ “Koco Gliozheni”*”, me nr. REF-42964-11-11-2019, me fond limit 67,179,240 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 16.12.2019, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Duke qënë se një situatë e tillë nuk është e rregulluar nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik i drejtohet ligjit nr.44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*” i cili në nenin 94, “*Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës*”, pika 1 parashikon se “*Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë.*”

III.1.2. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në objekt ankimimin e tij, dhe si pasojë mos shqyrtimit të ankesës së tij nga KPP lidhur me këto pretendime. Heqja dorë nga ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues sjell si rrjedhojë përfundimin e procedimit administrativ pa një vendim përfundimtar për çështjen.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

**Vendos:**

1. Të përfundojë procedimin administrativ për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur – Marrëveshje kuadër*”, me objekt “*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për SUOGJ “Koco Gliozheni”*”, me nr. REF-42964-11-11-2019, me fond limit 67,179,240 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 16.12.2019, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 61 Protokoli Datë 16.01.2020**

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**